



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**K O R N I Z A
A F A T M E S M E
B U X H E T O R E (KAB) e
K O M U N Ë S S Ë P O D U J E V Ë S
2013-2015**

Drejtoria për Buxhet, Financa

2012

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2013-2015

3.3 Donatorët e jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2013-2015

IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve


I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2013/2015 e lëshuar nga Ministria e Financave me dt. (14.05.2012).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritare të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2013-2015.

Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Podujevës, shtrihet në verilindje të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 633 km² ,në bazë te vlerësimeve zyrtare Podujeva ka 117.000 banorë.

Popullata shumicë është Shqiptare , me një përqindje te vogël te pakicave.

Në komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV-21 dhe KTV,
2. Radio - lokale – Radio Llapi,radio Vizioni
3. Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore,
4. Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kabllore.

Organizatrat joqeveritare, shoqatat të cilat merren me veprimtari kulturore e që funksionojnë në komunën e Podujevës janë:¹

1. OJQ “Provo Ndryshe” – Organizim i manifestimeve kulturore/ teatër
2. OJQ Dielli – Veprimtari teatrore
3. OJQ ART – Organizim manifestime shoqërore, art
4. OJQ Lart LABIRINTH – Art figurativ;
5. OJQ Vizioni i paqes – Art figurativ, ambient

Gjithsej biznese qe operojnë ne Komunën e Podujevës janë, 2.721 biznese, prej tyre janë :

NN- 227,

NTP- 370,

SHPK-160

NTSH-235

Auto taxi-246

NP- 178

Tregti lëvizëse TL-123

DPT-470

DPZ-320

DPH- 263

Te tjera – 129²

¹ “Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal” 2011-2014 , faq. 17

² “ Qendra e regjistrimit te bizneseve” Podujeve

Vizioni

Podujeva Komunë moderne, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, administratë moderne dhe efikase, arsim cilësor, mbrojtje shëndetësore dhe sociale, mirëqenie për të gjithë qytetarët, atraktive për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, ambient të përshtatshëm për biznes, ndërmarrësi të bazuar në iniciativën private, bujqësi dhe turizëm të zhvilluar .

Synimet :

Synimi 1. Krijimi i ambientit të përshtatshëm për biznese

Synimi 2. Zhvillimi i qëndrueshëm i Bujqësisë dhe Fshatit

Synimi 3. Zhvillim i qëndrueshëm hapësinorë dhe urban

Synimi 4. Përmirësimi i infrastrukturës fizike

Synimi 5. Përmirësim i shërbimeve shëndetësore dhe nivelit të mirëqenies sociale

Synimi 6. Sigurimi dhe ngritja e cilësisë në arsim

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR KOMUNËN E PODUJEVES

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Podujevës është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2013/2015 të dhëna nga MF-i përmes qarkores buxhetore 2013/01.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB–Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetet të tanishme dhe afatmesme të Podujevës si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2013-2015.

III. Korniza Fiskale Komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2013-2015 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Organizatrat buxhetore	Vlersimi	Projeksioni	Projeksioni provuses	
	2012	2013	2014	2015
Administrata komunale	5,813,557	6,295,712	6,295,712	6,295,712
Arsimi	6,846,965	6,846,965	6,846,965	6,846,965
Shëndetësia primare	1,998,692	2,028,673	2,028,673	2,028,673
Njësia e zjarrëfikasave				
Zyra lokale e komuniteteve	-			
Zyra për kthim	-			
Te hyrat vetanake	1,400,000	1,350,000	1,370,000	1,400,000
TOTALI ;	16,059,214	16,521,350	16,541,350	16,571,350

Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave si nga grandit e qeverisë, të hyrave vetanake komunale si dhe shpenzimeve).

1.1. Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.


Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

	Përshkrimi	2011 (aktual)	2012 (buxheti aktual)	2013 (plani)	2014 (vlerësimet)	2015 (vlerësimet)
1.	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	13,957,669	16,059,214	16,521,350	16,541,350	16,571,350
2.	TË HYRAT VETANAKE	1,075,000	1,400,000	1,350,000	1,370,000	1,400,000
2.1	Tatimi në Pronë	200,000	230,000	280,000	300,000	320,000
2.2	Taksat Komunale	480,000	720,000	705,000	705,000	715,000
	Licencat dhe lejet	80,000	230,000	200,000	200,000	210,000
	Certifikatat dhe doc zyrtare	110,000	175,000	110,000	110,000	110,000
	<i>Taksat për automjete</i>			145,000	145,000	145,000
	Lejet e ndërtimit	160,000	215,000	150,000	150,000	150,000
	Taksat e tjera Komunale	130,000	100,000	100,000	100,000	100,000
2.3	Ngarkesat Komunale	215,000	240,000	235,000	235,000	235,000
	Ngarkesat rregullative					
	Qiraja	60,000	80,000	60,000	60,000	60,000
	Bashkë-pagesat arsim	25,000	85,000	100,000	100,000	100,000
	Bashkë-pagesat shënd.	75,000	75,000	75,000	75,000	75,000
	Ngarkesat tjera komunale					
2.4	Të hyrat tjera	235,000	210,000	60,000	60,000	60,000
	Gjobat e Gjykates			70,000	70,000	70,000
2.5	Shitja e Aseteve					
2.6	Grantet dhe donacionet					
	Participimet e qytetarëve					

Grantet e huaja						
3.	TRANSFERET QEVERITARE	12,882,669	14,659,214	15,171,350	15,171,350	15,171,350
3.1	Granti i Përgjithshëm	5,317,649	5,813,557	6,295,712	6,295,712	6,295,712
3.2	Granti për Arsim	5,702,466	6,846,965	6,846,965	6,846,965	6,846,965
3.3	Granti për Shëndetësi	1,862,554	1,998,692	2,028,673	2,028,673	2,028,673
3.4	Grantet dhe Transferet tjera					

Tabela 3: Grafikoni me burimet e financimit



Korniza komunale e shpenzimeve buxhetore

Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2012.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të njëjtë për çdo vjet si dhe rritje të grandeve të qeverisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i grandeve të MF-it.

Tabela 3. Vlerësimet e hershme buxhetore 2013-2015

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Viti buxhetor (2012)				Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2013)				Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2014)				Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2015)			
	P&M	M&Sh	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Subvencione	Kapitali
Kryetari	107	18			107	20			107	20			107	20		
Kuvendi	132				132	10		20	132	10		20	132	10		20
D.Urbanizim	38	5		5288	42	9		3104	42	9		3124	42	9		3154
D. Kadaster dhe Gjeodozi	78	5			78	10			78	10			78	10		
D.Kultur Rini dhe Sport	79	15	30		79	20	50		79	20	50		79	20	50	
D.Inspekc	68	7			68	12			68	12			68	12		
D.Bujqsi	81	9	30		82	25	175		82	25	175		82	25	175	
D.Buxhet Administrat	162	17			158	16			158	16			158	16		
	277	330			277	495		38	277	495		38	277	495		38
TOTALI	1022	406	60	5288	1023	617	225	3162	1023	617	225	3182	1023	617	225	3212
							0									
Sherbim	144	58			144	153		1628	144	153		1628	144	153		1628
ZKK	9	2			9	2			9	2			9	2		
ARSIMI	6373	397	50	111	6683	321	50	350	6683	321	50	350	6683	321	50	350
SHEND.	1378	274	65	422	1394	285	50	425	1394	285	50	425	1394	285	50	425
ZLK																
SUB TO	8926	1137	175	5821	9253	1378	325	5565	9253	1378	325	5585	9253	1378	325	5615


SPECIFIKACION

TI KOMUNAL	VITI 2012 (000 EURO)	VITI 2013 (000 EURO)	VITI 2014 (000 EURO)	VITI 2015 (000 EURO)
	16,059	16,521	16,541	16,571

Tabela 4: Korniza Buxhetore Komunale, në euro

	Përshkrimi	2010 (aktual)	2011 (aktual)	2012 (buxheti aktual)	2013 (plani)	2014 (vlerësim et)	2015 (vlerësimet)
1.	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE		15,898,839	16,059,214	16,521,350	16,541,350	16,571,350
1.1	Të hyrat vetanake		1,075,000	1,400,000	1,350,000	1,350,000	1,350,000
1.2	Grantet dhe transferet qeveritare		14,823,839	14,659,214	15,171,350	15,171,350	15,171,350
2.	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE		15,898,839	16,059,214	16,521,350	16,541,350	16,571,350
2.1	Shpenzimet rrjedhëse		9,980,149	10,237,693	10,846,443	10,846,443	10,846,443
	Pagat dhe mëditjet		8,729,433	8,926,236	9,252,995	9,252,995	9,252,995
	Mallrat dhe shërbimet		1,101,168	1,136,457	1,378,448	1,378,448	1,378,448
	Subvencionet		149,548	175,000	325,000	325,000	325,000
2.2	Shpenzimet Kapitale		5,918,690	5,821,521	5,564,907	5,584,907	5,614,907
	Nga të cilat: Grantet e jashtme për projekte kapitale						
3.	BILANCI PRIMAR BUXHETOR						
3.1	Pagesa e interesit për borxhin e jashtëm						
4.	BILANCI TOTAL BUXHETOR						
5.	FINANCIMI						
5.1	Financimi i jashtëm						
	Ripagimi i borxhit kryesor						
	Huamarrja e jashtme						
5.2	Financimi i brendshëm						
	Shitja e aseteve						
	Huamarrja e brendshme						
	Ndryshimi në fitimet e pashpërndara						
6.	BILANCI BANKAR NË FUND TË VITIT						

Tabela 5: Grafikoni për shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike



Strategjia zhvillimore për sektorët komunal

Tabela 1. Strategjia e Drejtorisë

–Zyra e Kryetarit dhe Asambleja Komunale

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit: Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë të nivelit të qeverisjes lokale (nxjerrja e rregulloreve ,vendimeve, udhëzimeve,etj) në funksion të qeverisjes sa më të mirë dhe efikente të të gjitha drejtorive të Shërbimit civil të Komunës, gjithnjë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve me të gjitha drejtoritë e Shërbimit civil të Komunës, këshilltarëve të kuvendit të Komunës, Komiteteve obligative dhe Komiteteve jo obligative, me subjektet relevante të Nivelit Qendror dhe atij lokal, OJQ-të, biznesin, etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e komunës së Podujevës.

Vlerësimi i mundësive dhe sfidave gjatë periudhës buxhetore:

Realizimi sa më i mirë dhe me plani i të hyrave buxhetore komunale do të ndikonte në realizimin e projekteve të ndryshme kapitale dhe zhvillimore të Komunës, derisa ngecja në mos përmbushjen e tyre do të ndikonte në ngadalësimin e synimeve të tyre dhe me këtë edhe në zhvillimin e tërësishëm të Komunës.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe sfidave (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Një punë me efikasitet e Kuvendit të Komunës, Komiteteve obligative dhe Komiteteve jo obligative për realizimin e përgjegjësi, punëve dhe detyrave në të ardhmen do të ndihmonte në përshpejtimin e realizimit të programeve zhvillimore në Nivelin komunal .

Strategjia e Drejtorisë

Drejtoria për Administratë

Përmbledje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen(misioni/synimet):

Drejtoria e Administratës në pajtim me ligjet në fuqi dhe aktet tjera nënligjore është përgjegjëse në ofrimin e shërbimeve të përgjithshme administrative në kuadër të Administratës komunale si dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarë:

-Përgatitë materialet për mbledhje të Kuvendit të Komunës, të Komiteteve dhe të strukturave tjera organizative; ndihmon Kryetarin në punët dhe aktivitetet nga fushëveprimtaria e Drejtorisë; Shërbimin e Gjendjes Civile; arkivimin e lëndëve arkivore; mban regjistër dhe evidenton materialet zyrtare, që pranohen dhe dorëzohen nga depoja e Komunës; mirëmban pajisjet teknologjike; menaxhon njësinë e transportit- autoparkun e Komunës; kujdeset për shërbimet postare; shërbimet e sigurimit dhe mirëmbajtjes së objekteve; ofron ndihmat juridike-administrative qytetarëve; si dhe punë dhe aktivitete tjera në kuadër të fushëveprimtarisë së kësaj Drejtorie.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara(aktivitetet aktuale)

Bashkëpunon dhe koordinon punët dhe aktivitetet me Drejtorinë e Administratës komunale si dhe me institucionet tjera të Nivelit qendror; organizata dhe subjekte tjera vendore ndërkombëtare i në funksion të kryerjes së punëve dhe shërbimeve më cilësore.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Mosrealizimi i parashikimeve të hyrave vetanake redukton realizimin e planeve të kësaj Drejtorie dhe mos përmbushjen e kërkesave të ndryshme të qytetarëve, pastaj mungesa e lokaleve adekuate për kryerjen e punëve administrative të institucioneve komunale ndikon në zvogëlimin dhe efikasitetin e punëve dhe shërbimeve.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen);

Krijimi i një administrate efikase, transparente dhe moderne, për ofrimin e shërbimeve më të shpejta dhe cilësore për qytetarë.

**Strategjia e Drejtorisë
Drejtoria për Buxhet, Financa, Planifikim dhe Zhvillim**

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit:- Bënë përgatitjen, prezantimin e buxhetit komunal, si dhe menaxhimin e Buxhetit e Financave të Komunës. I siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit, menaxhimin e shpenzimeve dhe informon lidhshpërndarjen komunal me aktivitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve e aktiviteteve nëpër të gjitha Drejtoratet e Komunës .Bënë përcaktimin e kritereve për ndarjen e Buxhetit konformë limiteve të përcaktuara nga MF-ve.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Nëse të hyrat vetanake komunale nuk realizohen sipas planit, mund të vijë deri te reduktimi i investimeve kapitale të parapara me buxhet.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Qëndrueshmëria buxhetore , menaxhimi me efikasitet i shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike , sidomos ato që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik-investimet kapitale.

Spektori për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit: Të përmirësojë ambientin, për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Të zbatohet strategjia për zhvillimin ekonomik lokal. Drejtoria synon të themelojë “partneritet “ me komunitetin e bizneseve dhe të shohë rolin e saj si promovuese të përmirësimit të infrastrukturës si bazë për zhvillimin ekonomik.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve me të gjitha Drejtoritë e Komunës rreth implementimit të projekteve të ndryshme zhvillimore sipas prioriteteve e në pajtim me buxhetin e aprovuar. Ofrimi i projekteve të gatshme për donatorët e mundshëm si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi me organet qendrore dhe komunitetin për realizimin e projekteve si bashkëfinansues të mundshëm.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Mungesa e mjeteve buxhetore, mund të jetë përcaktues në mundësitë e zhvillimit ekonomik të Komunës.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Qeshtjet pronësoro-juridike mund të kenë një ndikim të mundshëm gjatë zhvillimit të proceseve dhe fazave të zhvillimit ekonomik dhe zbatimit konkret të programeve për investime.

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Sektori për Shërbime Publike

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka për detyrë ngritjen e cilësisë dhe zgjerimin shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: trajtimin e ujërave të zeza(kanalizimin fekal);mbeturinat (bashkëpunimin me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave);furnizimi me ujë të pijës(bashkëpunimi me kompaninë e ujësjellësit); zgjerimin e sistemit të ndriçimit publik;sigurimin dhe mirëmbajtjen parqeve publike, hapësirave të hapura ; lëshimin e lejeve për shërbime ,siç janë lejet përshfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike, lejet për orarin e udhëtimeve për operatorët e transportit të udhëtarëve, shërbimet e auto dhe radiotaksive; përmirësimin e infrastrukturës ligjore(Rregulloreve) për transportin lokal publik,etj.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve në mes të Drejtorive ,si me : Drejtorinë e Inspeksionit , Drejtorinë e Urbanizmit, institucionet qendrore(me të cilat ka ndërvarshmëri të punës),kompanitë publike për shërbime,etj.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Buxheti i pamjaftueshëm dhe paraqitja e rasteve emergjente, si për shërbime ashtu edhe për investime kapitale.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive the kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Qëndrueshmëria buxhetore , krijimi i Fondit për raste emergjente.

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet): Hartimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera; Vlerësimin e rrezikshmërisë, duke u bazuar në të dhënat faktike për planifikim,ndërmarrjen e masave parandaluese për pengimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi me nivelin qendror dhe agjencionet tjera për emergjenca dhe siguri,siç janë : DME, QOER, PK, FSK, SHZ, KFOR.

Njofton Drejtoritë dhe subjektet tjera në rast rreziku për pronat, njerëzit, ndërtesat, rrugët, fabrikat etj.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Buxheti i pamjaftueshëm dhe rastet emergjente të paplanifikuara.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive the kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Buxhet të qëndrueshëm dhe planifikim sa më gjithëpërfshirës për rastet emergjente.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtja e Mjedisit

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit:- Zbaton rregullativen ligjore dhe nën ligjore nga lëmi i planifikimit hapësinor:

Planit zhvillimor të Komunës, planit zhvillimor urban, planeve rregulluese urban si dhe rregullativën nga lëmi i ndërtimeve investive, dhe të infrastrukturës.

Përcakton kushtet urbanistike dhe arkitektonike, hartimin e dokumentacioneve investivo – teknike për ndërtimin e objektit lidhur me realizimin e projekteve kryesore urbanistike dhe zgjedhjet e tyre arkitektonike:

Organizon dhe bënë mbikëqyrjen profesionale gjatë ekzekutimit të punimeve të ndërtimit, rindërtimit dhe pranimit teknik të objekteve në bazë të ligjit dhe akteve nenligjore.

Propozon standarde për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro urbane në territorin e Komunës.

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, kjo drejtori angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik të madhë për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;

Bën mbrojtjen e biodiversitetit, duke tentuar arritjen e balancit ekologjik në territorin e Komunës dhe më gjërë;

Bën mbikëqyrjen për shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të tokës prodhuese, si dhe mbrojtjen e akulimeve gjenetike të natyrës; etj.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitet aktual):

Koordinimi i mirë i punëve dhe aktiviteteve si në stafin e drejtorisë, ashtu edhe me drejtoritë tjera siç janë: Drejtorinë e Inspektionit, Drejtorinë për pronë Kadastrës dhe gjeodezisë, Drejtorinë për shërbime publike dhe institucioneve tjera lokale dhe qendrore.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Nëse të hyrat vetanake komunale nuk realizohen sipas planit, mund të vijë deri te reduktimi i projekteve të miratuara në Kuvend.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

, Qeshtjet pronëso- juridike të padefinuara, mungesa e pronës komunale, vonesa e miratimit të PZHK- dhe planeve rregulluese urbane.

Strategjia e Drejtorisë

Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):
Deklarata e misionit: DSHMS- ka për mision të vetin të sigurojë dhe zhvillojë sistemin e ofrimit të kujdesit parësor shëndetësor sa më cilësor , duke u bazuar në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës s onë dhe të marrë masa parandaluese karshi shfaqjes së sëmundjeve ngjitëse , duke bërë imunizimin e popullatës sipas kalendarit vaksinal.
Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):
Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve nëpër të gjitha QMF dhe AMF në qytet dhe vendbanimet rurale duke ofruar shërbime mjekësore parësore sa më afër popullatës.
Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:
Mungesa e mjeteve buxhetore , shkurtimeve financiare dhe në numër të punëtorëve ,ndikojnë për mospermbushjen e misionit dhe synimit te kësaj drejtorie.

Strategjia e Drejtorisë

Drejtoria për Kulturë,Rini dhe Sport

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet)
Deklarata e misionit: Krijimi dhe mbështetja e subjekteve dhe individëve krijues kulturor, aktiviteteve rinore dhe sportive në nivel të komunës. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm vlerash konkurruese ,përmes themelimit te institucioneve profesionale : - teatro,orkestër, galeri .
Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale)
Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve me subjektet e ndryshme krijuese. Mbështetja e avancuar e krijuesve kulturor e artistik në ndërmarrjet konkrete dhe aktivitetet me interes te veçantë përfaqësimi. Koordinimi i aktiviteteve me organizatat rinore dhe avancimi i pjesëmarrjes së të rinjve në politikat e zhvillimit kulturor dhe aktiviteteve rinore masivizuese. Koordinimi me të gjitha klubet sportive dhe krijimi i hapësirave për aktivitete rekreative – sportive dhe garave konkurruese në nivele të ndryshme
Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore
Potenciali krijues dhe organizativ shpesh është në s'përputhje me mundësitë buxhetore. Mungesa e buxhetit e pezullon aktivizimin e synimeve programore të zhvillimit.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen)

Avancimi i politikave buxhetore në mbështetje të synimeve për zhvillimin e kulturës, artit, masivizimin dhe funksionalizimin e aktiviteteve rinore dhe sportive. Krijimi i kushteve sa më të favorshme për zhvillimin e kulturës, deri te gjetja e modelit specifik të zhvillimit të kulturës në bazë të resurseve ekzistuese te specifikuara. Gjetja e hapësirave të reja shprehëse dhe mbështetëse për zhvillimin e proklamuar të kulturës, aktiviteteve rinore dhe sportive për të gjithë.

Strategjia e Drejtorisë

Sektori për Bujqësi ,Pylltari dhe Zhvillim rural

PËRMBLEDHJA E RRJEDHIMEVE QË KERKOHEN NË ARRITJEN E SYNIMEVE

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim rural bënë menaxhimin e stafit të Drejtorisë, burimeve financiareve dhe bënë koordinimin me Agjencionet tjera qeveritare për aktivitete bujqësore dhe Zhvillim Rural në territorin e komunës së Podujevës.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale)

Përgatit planin për mbjellje vjeshtore dhe pranverore dhe siguron që këto plane te zbatohen. Koordinon punët me OJQ me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve bujqësore, lidh dhe bashkëpunoi me Kooperativat bujqësore të ju afroi trajnime dhe shërbime tjera veterinarë, blegtorale etj. Koordinoi po ashtu edhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të gjuetisë, pylltarisë etj.

Resurset bujqësore si toka pjellore e mjaftueshme dhe cilësore për kultivimin e Pemëve dhe perimeve, është prioritet ndër prioritetet bujqësore afat të mesme.

Ruajtja – mbrojtja e tokës bujqësore nga copëtimi i mëtutjeshëm dhe nga ndërtimet në tokat bujqësore.

Përmirësimi i kushteve (deri më tani të pa volitshme) për kreditimin e fermerëve, investimeve të ndryshme në bujqësi si dhe investimet e kapitalit të punëtorëve që kishin me u kthye nga bota e jashtme.

Investimet në rregullimet e sistemeve për ujitje të sipërfaqeve bujqësore e posaçërisht të atyre që shtrihen për gjatë lumit Llap

Ngritjen e minifermave në fshatra dhe mbushjen e tyre me lope qumështorë , me viça për trashje pra për majmëri etj.

Investime në ngritjen e ndonjë qumështoreje për përpunimin e qumështit një ditore dhe atij ne tetrapak .

Investime në rritjen e numrit të fermave të pulave vojse , zogjve për trashje (brojlerve) etj.

Bashkëpunojmë me fermer që posedojnë bletë dhe mundohemi për rritjen e numrit të tyre pasi që bletaret e komunës sonë kanë një traditë në kultivimin e bletëve.

Ngritjen e disa minifermave – hurdhave të peshqve për majmëri dhe shtim.

Investime në rritjen e grumbullimit të bimëve mjekuese dhe prodhimeve pyjore si (kpuardhave) dhe bimëve tjera pyjore.

Investime në turizëm pasi që treva e komunës posedon kushte ideale për këtë lami.

Vlerësimi i mundësive dhe nevojave për periudhën buxhetore:

Plani i realizimit të misionit do të vështirësoi nëse nuk përmbushën të hyrat buxhetore. Kushtet atmosferike që do të ndikonin në realizimin dhe rendimentet e lartë cekura.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve(aktivitete) të propozuara

Kushtet atmosf. që do të ndikojshin në rendimentet bujqësore duhet të trajtohen dhe të ju ipet një tretman i posaçëm pasi që ka ndikim të madh në bujqësi. Si të reshurat atmosferike breshëri,ngricat e ndryshme vërshimet.

Drejtoria për Pronë , Kadastër dhe Gjeodezi

Përmbledhja e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni /synimet):

Drejtoria për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi bazuar në ligjet pozitive , udhëzimet administrative, të cilat në mënyrë specifike dhe të veçantë rregullojnë marrëdhëniet lidhur me pronat e paluajtshme të qytetarëve. Me kërkesën e palëve bënë regjistrimin e tyre në librat kadastral, si dhe bartjen e tyre nga një subjekt në tjetrin, konform akteve juridike : kontratave , aktgjykimeve të gjykatave. Kryen të gjitha veprimet procedurale lidhur me uzurpimet ,ekspropriuimet,shpronësimet,dhënien në shfrytëzim me qira të pronave komunale. Me kërkesën e palëve gjeodetët dalin në teren ku bëjnë matjet gjeodezike varësisht prej kërkesës së palëve(Parcilimet dhe Bashkimet; Matjet e ndërtesave dhe Matjet e pjesëve të ndërtesave; Matjet e përçojave; Përcaktimi i kufinjëve të parcelave dhe rirregullimi i kufinjëve të parcelave; Dhënja e dëshmimeve nga baza e të dhënave kadastrale – tekstuale apo grafike sipas kërkesës së palëve; Punët e zyrës sipas kërkesës së palëve; Baza gjeodezike dhe Punët e veçanta gjeodezike).

DPKGJ-ja është përgjegjëse dhe mbanë edhe marrdhenije të ngushta me Qeverinë qendrore-Ministrinë e Ambientit,dhe Planifikimin Hapësinor; Ministrinë e Shërbimeve Publike; Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ;Agjencionin Kadastral të Kosovës; Agjencionin Kosovar të Privatizimit; Agjencionin Kosovar të Pronës

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve të administratës me zyrën e pronës; zyrën e kadastrës dhe zyrën e gjeodezisë

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve (rreziqeve) gjatë periudhës buxhetore:

Mosrealizimi i parashikimeve të hyrave komunale.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve, (aktivitetet e propozuara për të ardhmen): Mungesa e mjeteve buxhetore , mos realizimi i të hyrave vetanake , do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetet e kësaj drejtorie.

**Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal sipas Limitit të parë
buxhetor të arritur nga MF-i**

Nga MF-i, me dt. 14.05.2012 kanë arritur limitet e para buxhetore për Komunat për periudhën 2013-2015. Grandi fillestarë i Qeverisë për Komunën e Podujevës është si vijon:

Limiti fillestar	Grand.përgj	Grand.arsim	Grant.Shëndet.	Gjiths.Granti komunal
2013-Limiti. fillestar	6.295.712	6.846.965	2.028.673	15.171.350
2014-Limit indikativ	6.295.712	6.846.965	2.028.673	15.171.350
2015-Limit indikativ	6.295.712	6.846.965	2.028.673	15.171.350

Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal për vitet 2013-2015, sipas Programeve buxhetore dhe në bazë të Limiteve të para Buxhetore të caktuara nga ana e Komisionit të Grandeve të MF-it, janë si vijon:

Projeksioni i të hyrave Buxhetore 2013-2015 të Komunës së Podujevës

KK-Podujevë	Buxheti - 2013	Buxheti - 2014	Buxheti - 2015
Të hyrat nga.Grandi Qeverisë	15.171.350	15.171.350	15.171.350
Të hyrat vetanake	1.350.000	1.370.000	1.400.000
TOTALI:	16.521.350	16,541,350	16,571,350

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2013-2015 SIPAS LIMITIT TË PARË

KK-Podujevë	Buxheti - 2013	Buxheti - 2014	Buxheti - 2015
Paga dhe mëditje	9,252,995	9,252,995	9,252,995
Mallra dhe shërbime	1,378,448	1,378,448	1,378,448
Subvencione	325,000	325,000	325,000
Investime kapitale	5,564,907	5,584,907	5,614,907
TOTALI:	16.521.350	16,541,350	16,571,350
Burimet e financimit			
Grandi i Qeverisë	15.171.350	15.171.350	15.171.350
Të Hyrat vetanake	1.350.000	1.370.000	1.400.000
TOTALI:	16.521.350	16,541,350	16,571,350

Programi komunal i investimeve publike (PIP)

Programi komunal për Investime publike përfshinë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2013-2015 nga ana e Kuvendit të Komunës së Podujevës sipas proceseve buxhetore të zhvilluara gjatë vitit 2012.

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me Buxhetin e vitit 2013 , 2014 dhe 2015 te parapara nga grandit dhe të hyrat vetanake. Kjo listë mund te modifikohet me propozime të reja që do te vinë nga Drejtoritë gjatë këtij shqyrtimi-punëtorie me Drejtorët e Drejtorive dhe strukturat tjera udhëheqëse dhe organeve relevante komunale për hartimin e politikave zhvillimore te Komunës duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim si dhe aftësive dhe burimeve të ardhurave komunale , si dhe Grandet e Qeverisë dhe Donatorët e ndryshëm.

Duhet të theksojmë se arsyetimet e dhëna për projektet që pritet të financohen gjatë vitit fiskal 2012 nga të hyrat vetanake si dhe ato të dërguara ne MF-ë për financim eventual nga donatorët gjatë muajit dhjetor 2012, janë vlerësuar mjaft mirë nga kompetentet për përcjelljen e projekteve .

Përshkrimi i projekteve prioritare për vitin 2013

Drejtoria për Urbanizëm

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	2,803,907.00	300,000.00	3,103,907
1	Asfaltimet e rrugëve - rrugicave në qytet	400,000	50,000	450,000
2	Rregullimi i hapësirave publike(gjelbërim,oaza,rrethe...)	50,000	20,000	70,000
3	Hartimi i projekteve	20,000		20,000
4	Asfaltimi i rrugës Letanc- Peran	115,000		115,000
5	Rregullimi i shtratit të lumit Llap - vazhdim	40,000	10,000	50,000
6	Projektet e përfunduara vitin paraprak	220,000	20000	240,000
7	Mirëmbajtja e ambientit, shesheve , parqeve	40,000	50,000	90,000
8	Participim me donatorë	40,000	20,000	60,000
9	Asfaltimi i rrugës lagja Kralefci	40,000	30,000	70,000
10	Asfaltimi i rrugës Peran - lagja Qosaj	70,000		70,000
11	Asfaltimi i disa rrugicave ne f. Llapashtice	50,000		50,000
12	Asfaltimi i rrugës në fshatin Repë	60,000		60,000
13	Asfaltimi i rrugës Sekirag- Sfeqel	140,000		140,000
14	Asfaltimi i rrugës Orllan- Ballaban	50,000		50,000
15	Asfaltimi i rrugës Obranqë-Peran (kah shkolla)	80,000.00	10,000	90,000.00

16	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ballofc,	140,000.00	25,000	165,000.00
17	Asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Batllavë	40,000.00		40,000.00
18	Asf. i rrugëve Obrazhda, Jupolli, Bekolli Shajkofc	120,000.00		120,000.00
19	Asfaltimi i rrugëve Kosumi,Abdyli,Mustafa Gllamnik	150,000.00		150,000.00
20	Asfaltimi i rrugës Sollobëjë - Majac	60,000.000		60,000.00
21	Asfaltimi i rrugëve Bradash	290,000.00		290,000.00
22	Asfaltimi i rrugës unazore te lagja e Kuvajtit	60,000.00	20,000	80,000.00
23	Asfaltimi i rrugës Zakutë - Dobërdol	50,000.00		50,000.00
24	Asfaltimi i rrugës lagja Uglari Metehi	50,000.00		50,000.00
25	Plani Rregullues Urban	30,000.00		30,000.00
26	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sfeçël	120,000.00	25,000	145,000.00
27	Asfaltimi i rrugëve në Dumnice e Poshtme	75,000.00		75,000.00
28	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lupq i Poshtëm	70,000.00	20,000	90,000.00
29	Asfaltimi i rrugës "Emin Duraku"	43,907.00		43,907.00
30	Asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Bellopojë	30,000.00		30,000.00
31	Asfaltimi i rr. lagja Kuletolli,Podvorica dhe Zagragja	60,000.00		60,000.00

Drejtoria për Shërbime Publike -2013

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	1,446,000	182,000	1,628,000
1	Kan fek Dumnicë e Poshtme- vazhdimi	70,000	-	70,000
2	Ndërtimi i trotuareve	80,000		80,000
3	Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Sveçël-Balloç	100,000	20,000	120,000
4	Pastrimi dhe zgjerimi i shtratit te lumenjve	35,000		35,000
5	Kan fek Sfeçël	65,000	40,000	105,000
6	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	14,000	-	14,000
7	Ujësjiellësi Shajkoc-Orllan	45,000		45,000
8	Inv kap raste emergjente	25,000		25,000
9	Ndërtimi dhe riparimi i kan fek në qytet	60,000	30,000	90,000

10	Shenjzimi vertikal dhe horizontal,tabelat e emërtimit të rrugëve	15,000		15,000
11	Kan fek Bellopojë-Tërnavë- Halabak vazhdimi	45,000		45,000
12	Kan fek Miroc	32,000		32,000
13	Tregu i Qytetit(faza përfundimtare- tregu me shumicë)	80,000		80,000
14	Riparimi dhe ndërtimi i kanalizimeve atmosferike	25,000		25,000
15	Meremetimi i rrugëve të asfaltuara dhe pusetave	20,000		20,000
16	Kan fek Llapashticë e Poshtme	70,000		70,000
17	Kan fek Llapashticë e Epërme	105,000		105,000
18	Ndërtimi dhe riparimi i urave(Gllamnik,Dobërdol,etj.)	30,000		30,000
19	Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit	15,000		15,000
20	Rregull. dhe mirëmbajtja e varrezave dhe monumenteve	20,000		20,000
21	Kan fek në fshatra(Gërdoc, Dumnicë e Epër, Revuç,Lupç)	82,000		82,000
22	Rregullimi i rrugëve me zhavorr	70,000	20,000	90,000
23	Rreg .i murit mbrojtës,kan fek(lagjja çitaku,muqolli Bajqinë)	30,000		30,000
24	Kan fek Pakashticë e Poshtme	35,000		35,000
25	Kan fek Konushec	32,000	10,000	42,000
26	Meremetimi i rrugës,kan atmosferik,rip i urës(Dvorishtë dhe Sllatinë)	30,000		30,000
27	Kan fek Dobratin- vazhdimi	106,000	4,000	110,000
28	Kan fek në fshatra (Dobërdol,Peran,Metehi,Katunishtë,Gllamnik)	60,000	30,000	90,000
29	Mbyllja e deponive te egra	8,000		8,000
30	Kan fek në fshatra(Siboc,Repë,Batllavë,Kërpimeh,Llaushë)	42,000	28,000	70,000

Drejtoria e Administratës

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	30,000	8,000	38,000
1	Blerja e gjeneratorit	30,000		30,000
2	Aparate fotokopjimi		8,000	8,000

Drejtoria e Bujqësisë - projektet kapitale te financuara nga Subvencione dhe transfere

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	0	175,000	175,000
1	Projektet për mbjellje pranverore		30,000	30,000
2	projektet për blegtori		50,000	50,000
3	Projekti për rritjen e kapaciteteve te serrave		20,000	20,000
4	Projektet për ngritjen e sipërfaqeve te reja me peme		15,000	15,000
5	Projekte për bletari		5,000	5,000
6	Projekte për rregull. e infrastrukturës për ujitje		30,000	30,000
7	Projektet për mbjellje vjeshtore		25,000	25,000

Drejtoria e Shëndetësisë

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	425,000	-	425,000
1	Ndërtimi i shtëpive për raste sociale	100,000		100,000
2	Ndërtimi i objektit te maternitetit-faza e II	215,000		215,000
3	Dezinfektim,Deratizim,dhe Dezinsektim	40,000		40,000
4	Pajisje mjekësore për QMF ne Podujeva II	45,000		45,000
5	Renovimi i objekteve shëndetësore	25,000		25,000

Drejtoria e Arsimit

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	250,000	100,000	350,000
1	Ndërtimi i shkollës në fshatin Batllavë	250,000	100,000	350,000

Projektet kapitale për vitin -2014

Drejtoria për Urbanizëm

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	4,115,000	410,000	4,525,000
1	Hartimi i projekteve	50,000	30,000	80,000
2	Rregullimi i hapësirave publike	50,000	20,000	70,000
3	Asfaltimet e rrugëve - rrugicave në qytet	350,000	35,000	385,000
4	Asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Dobërdol	105,000		105,000
5	Kapitale tjera (të imta)	105,000	20,000	75,000
6	Asfaltimi i rrugës Bajqinë-lagja Sogojeva-vazhdim	195,000		195,000
7	Asfaltimi me shtresa mbrojtëse 4cm.	250,000		250,000
8	Mirëmbajtja e ambientit, shesheve, parqeve etj.	80,000	10,000	90,000
9	Participim me donatorë	200,000	30,000	230,000
10	Asfaltimi i rrugës Podujevë - Livadicë	300,000	55,000	355,000
11	Asfaltimi i rrugës lagja Softolli - Bunjaku Lladofc	80,000.00		80,000
12	Asfaltimi i rrugës Gajtave vazhdim Orllan	30,000.00		30,000
13	Ndërtimi i rrugës Kerpimeh - Sylevic	120,000	30,000	150,000
14	Ndërtimi i rrugës Pakashtic-Qenog	110,000		110,000
15	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dobratin	120,000	30,000	150,000
16	Asf.rr. Haxhi Sadria-vazhdim gallapi	150,000	20,000	170,000
17	Ndërtimi i rrugës Murgull- Marincë faza e I-rë	110,000	30,000	140,000
18	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llapashticë	110,000	10,000	120,000
19	Asf. rrugës Dumnicë - Merdar	150,000	70,000	220,000
20	Asfaltimi i rrugës Katunishtë - Bradash	170,000		170,000
21	Asf.rr. Kerpimeh-lagja Imeri,Xhemajli,Islami,Oraca,Jakupi	60,000		60,000
22	Asf. i rr. Kurtolli, Podvorica e Zagragja Tërnavë	100,000		100,000
23	Asfaltimi I disa rrugicave në f. Kaqybeg	100,000	10,000	110,000
24	Asfaltimi I disa rrugicave në f. Sibofc I Epërm	80,000	10,000	90,000
25	Asf. i disa rrugicave Batllavë	95,000		95,000
26	Asfaltimi i rrugës në fshatin Surdull (faza e dytë)	400,000		400,000
27	Asfaltimi i rrugës në fshatin Revuqë - vazhdimi	80,000		80,000

28	Asfal. i rrugës te ura e Fushalive rruga për Letanc	80,000		80,000
29	Asfaltimi i rrugës Bervenik - Metergofc faza II-të	285,000		285,000

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	2,050,000.00	260,000.00	2,310,000.00
1	Ndërtimi I trotuareve	100,000	25,000	125,000
2	Rregullimi dhe mirëmbajta ndriçimit publik	50,000		50,000
3	Mbyllja e deponive te egra	30,000		30,000
4	Inv kap raste emergjente	75,000		75,000
5	Meremetimi i rrugëve të asfaltuara dhe pusetave	52,000		52,000
6	Rregullimi dhe mireme e varrezave dhe monumenteve	45,000		45,000
7	Rregullimi I kolektorit për ujerat e zeza Lumi Llap	200,000	100,000	300,000
8	Pastrimi dhe zgjerimi I shtratit Penda(Liqeni I Batllaves)-Shakovice	150,000	70,000	220,000
9	Zgjerimi I urës ne Lupc I Poshtëm	15,000		15,000
10	Kan fekal ne qytet dhe fshatra	95,000		70,000
11	Kolektori I ujerave te zeza,Balloc-Shtedim-Dumnice	200,000	50,000	250,000
12	Pastrimi dhe zgjerimi I shtratit te lumit Llap nga Lupci ne I Pireva	108,000		108,000
13	Rregullimi I rrugëve me zhavorr	90,000	15,000	105,000
14	Shenjezimi vertikal dhe horizontal	35,000		35,000
15	Rreg i rrugeve te kat 4	50,000		50,000
16	Rregullimi I rrugëve me kubeza	95,000		95,000
17	Pastrimi dhe zgjerimi I shtratit te lumenjve	105,000		105,000
18	Ujësjetlësi Shajkofc-Orllan F II	90,000		90,000
19	Ndërtimi dhe riparimi I urave	20,000		20,000
20	Rregullimi i stacioneve për transport publik	75,000		75,000
21	Ujësjetlësi Llapashtice e Epërme	55,000		55,000
22	Riparimi dhe rregullimi I kan atmosferike	40,000		40,000
23	Kolektori I ujerave te zeza, Llapashticë, Gllamnik	80,000		80,000
24	Kapitale te imta	25,000		25,000
25	Kan fekal Lupq I Eper-Popove	65,000		65,000

26	Kan Dyz	40,000		40,000
27	Ndërtimi I urës Metehi	15,000		15,000
28	Ujësjiellësi Dobratin	50,000		50,000
29	Ujësjiellësi Llapashtice e Epërme	55,000		55,000

Drejtoria e Shëndetësisë

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	425,000	-	425,000
1	Ndërtimi i shtëpive për raste sociale	100,000		100,000
2	Ndërtimi i objektit të maternitetit-faza e III	200,000		200,000
3	Dezinfektim, Deratizim, dhe Dezinfektim	20,000		20,000
4	Furnizim me një rëntgen digjital për QKMF	50,000		50,000
5	Renovimi i objekteve shëndetësore	55,000		55,000

Projektet kapitale për vitin -2015

Drejtoria për Urbanizëm

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	2,495,000	80,000	2,575,000
1	Ndërtimi i trotuareve			
1	Plani Rregullues Urban	40,000	60,000	100,000
2	Projektet e bartura nga viti I kaluar	185,000		185,000
3	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sfeqël	120,000		120,000
4	Asfaltimi i rrugës lagja Bajgora Ballofc	110,000		110,000
5	Hartimi i projekteve	50,000		50,000
6	Rregullimi i hapësirave publike	80,000		80,000
7	Asfaltimi i rrugëve në qytet	150,000		150,000
8	Rregullimi i rrugëve me kubeza	220,000		220,000
9	Asfaltimi i rrugës Kerpimëh-Sylevic (vazhdim)	150,000		150,000
10	Asfaltimi i rrugës Pakashticë - Qenog (vazhdim)	110,000		110,000
11	Asfaltimi i rr. Dobratin –lagja Prronaj-Bajgorët	120,000		120,000
12	Asf.rr. Haxhi Sadria-vazhdim gallapi	200,000	20,000	220,000

13	Asf. rrugës Murgull- Marincë faza e I-rë	100,000		100,000
14	Asfaltimi i rrugës Orllan - Kushevicë	160,000		160,000
15	Asf. rrugës Dumnicë - Merdar (vazhdim)	150,000		150,000
16	Asf.me shtresë mbrojtëse 4cm	300,000		300,000
17	Asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Sfeqël	100,000		100,000
18	Participim me donator	150,000		150,000
19	Asfaltimi i Bradash - Dobratin	150,000	20,000	170,000
20	Asfaltimi i rrugës Kushevicë - vazhdimi	90,000		90,000
	GJITHËSEJTË:	2,495,000	80,000	2,575,000

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	1.519.000	225.000	1.744.000
1	Ndërtimi i trotuareve	95,000	25,000	120,000
2	Inv kap raste emergjente	105,000		105,000
3	Meremetimi i rrugëve të asfaltuara dhe pusetave	90,000	30,000	120,000
4	Rregullimi I kolektorit per ujerat e zeza F II Llap	375,000		375,000
5	Rregullimi dhe mireme e varrezave dhe monumenteve	75,000		75,000
6	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik	60,000		60,000
7	Rregullimi I rrugëve me zhavorr	75,000	50,000	125,000
8	Shenjëzimi vertikal dhe horizontal	40,000		40,000
9	Mbyllja e deponive te egra	22,000		22,000
10	Rreg i rrugëve te kat 4	45,000		45,000
11	Pastrimi dhe zgjerimi I shtratit te lumenjve	85,000	20,000	105,000
12	Kan fekal ne qytet dhe fshatra	125,000	50,000	175,000
13	Riparimi dhe rregullimi I kan atmosferike	52,000	30,000	82,000
14	Kapitale te imta	25,000	20,000	45,000
15	Pastrimi dhe zgjerimi I shtratit te lumit Llap(fytet e ngushta)	85,000		85,000
16	Kolektori i ujerave te zeza Dumnica, vazhdim	90,000		90,000
17	Kolektori i ujerave te zeza lumit Llapashtica vazhdimi	75,000		75,000

Drejtoria e Shëndetësisë

Nr.	Emërtimi i projektit	Granti	Te hyrat vetanake	Totali
	Total Buxheti	425,000	-	425,000
1	Ndërtimi i shtëpive për raste sociale	100,000		100,000
2	Ndërtimi i objektit të maternitetit-faza finale	215,000		215,000
3	Dezinfektim, Deratizim, dhe Dezinfektim	20,000		20,000
4	Blerja e një autoambulance për QKMF	50,000		50,000
5	Renovimi i objekteve shëndetësore	40,000		40,000

PERFORMANCA E DREJTORIVE

Zyra e Kryetarit

Deklarata e misionit : *Është posti më i lartë politik në Komunë*

Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj; Udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe Administratën e saj si dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës; Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës

apo Komiteteteve të tij; Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës; Emëron apo shkarkon zëvendësin e tij; Emëron dhe shkarkon drejtorët e Drejtorive të Administratës komunale; Organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;

